



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

Legjislatura VIII  
*Sesioni vjeshtor*

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**

P-nr. 94/2024

Prishtinë, më 25.09.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10.

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Arjeta Fejza, Albana Bytyqi, Drita Millaku, Labinotë Demi-Murtezi, Ariana Musliu- Shoshi, Eliza Hoxha dhe Duda Balje.

Munguan: Nasuf Bejta, Fatmire Kollçaku dhe Marigona Geci.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit dhe Sulltane Gashi, zyrtare e lartë në Komision.

Pjesëmarrës të tjerë: Gent Ramosaj-GP-AAK; Erblina Vataj, praktikante, “Democracy+”, Marigona Pajaziti, KK; Yllka Kllokoqi, KDI; Kaltërina Ibërdemaj, GP-VV; Celal Ilyas, Kuvendi i Kosovës dhe Besarta Pllana, Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi Duda Balje, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10 korrik 2024;
3. Miratimi i raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror të vitit 2024;
4. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor të vitit 2024;
5. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetarja**, fillimisht, përshëndeti anëtarët e komisioni dhe të pranishmit, duke uruar për fillimin e mbarë dhe të suksesshëm të sesionit vjeshtor.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10 korrik 2024**

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 10 korrik, 2024.

## **3. Miratimi i raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror të vitit 2024**

**Kryetarja** konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, miratoi raportin e punës së Komisionit për sesionin pranveror të vitit 2024.

## **4. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor të vitit 2024**

**Kryetarja**, duke qenë se prania në komisione është obligim, sugjeroi që të komunikojnë më shumë për të caktuar prioritetet që mund të realizohen deri në fund të vitit, konkretisht deri në muajin dhjetor.

**Arjeta Fejza**, tha se sa i përket zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si komision, kanë kontaktuar disa institucione dhe beson që dy muaj kanë kohë që ata të kenë mundësi të reflektojnë për udhëzimet administrative. Mendon që është mirë prapë t'iu dërgohet një shkresë nga komisioni dhe t'i pyesim se ku janë në nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatim të atij ligji. Nëse ata nuk japin informacion kthyes, mund t'i thërrasim edhe në takim.

Po ashtu, ajo tha se në muajin tetor duhet gjithsesi të ketë aktivitete për muajin e ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit dhe propozoi të përfshihet edhe në plan të punës.

**Kryetarja** përkrahu propozimin e deputetes Fejza, duke shtuar se komisioni duhet të vizitojë Repartin e Radiologjisë, në kuadër të aktiviteteve të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, duke rikujtuar vizitën e mëparshme në onkologji.

**Albana Bytyqi**, uron që ky sesion vjeshtor të shkojë më mirë se sesioni pranveror, duke theksuar se nuk është bërë mjaftueshëm për një komision kaq të rëndësishëm. Ajo përmendi shqyrtimin e dy projektligjeve të rëndësishme, atij për personat e zhdukur dhe mbrojtjen nga diskriminimi, të cilat sipas strategjisë legjislative të qeverisë, janë planifikuar të miratohen më 20 dhjetor 2024. Ajo propozoi që komisioni të fokusohet më shumë në këto projektligje.

**Kryetarja**, se sa i përket Projektligjit për personat e zhdukur dhe Projektligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, tha se derisa qeveria nuk e procedon projektligjin në Kuvend, ne nuk mund ta procedojmë.

Si komision, ose mund të presim, ose mund të marrim iniciativë ta bëjmë vet, ashtu qysh e kemi bërë Ligjin kundër dhunës në familje.

**Ariana Musliu- Shoshi**, theksoi rëndësinë e aktiviteteve të vetëdijesimit për kancerin e gjirit dhe dhunën në familje, veçanërisht ndaj grave, e cila është në rritje. Ajo u angazhua për aktivitete edhe më të mëdha të komisionit, duke deklaruar se komisioni duhet të bëjë më shumë gjëra konkrete. Ajo theksoi që mbrojtja e të drejtave të njeriut është një punë

elementare e komisionit dhe ka shumë vendime gjyqësore që duhet të trajtohen si tema në këtë komision, për të treguar se komisioni është aktiv dhe serioz në detyrat e tij.

Ajo propozoi që komisioni të organizojë një vizitë në burgje, për të monitoruar respektimin e të drejtave të burgosurve, veçanërisht për gratë dhe të miturit. Ajo sugjeroi që muajt e mbetur të shfrytëzohen për të organizuar dy aktivitete: një për vetëdijesimin për kancerin e gjirit dhe një për dhunën në familje.

**Labinotë Demi-Murtezi**, theksoi se komisioni ka bashkëpunuar mirë dhe ka pasur mirëkuptim mes anëtarëve të komisionit, pra edhe me deputetët e opozitës, duke përmendur raste ku Partia Demokratike e Kosovës kishte vendosur të mos votojë disa çështje.

Ajo shtoi se komisioni ka bërë maksimumin në terren, përfshirë monitorimin e burgjeve për meshkuj, femra dhe fëmijë. Më tej, tha se komisioni ka mbajtur tryeza, ka dhënë opinione publike dhe ka miratuar konkluzione të përbashkëta për disa çështje të rëndësishme. Ajo gjithashtu përmendi angazhimin lidhur me te drejtat e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës dhe komunikimet që, si komision, i kishin me Komisionin Qeveritar për këtë çështje, disa herë.

**Kryetarja**, tha se duhet të koncentrohemi tash edhe për dhunën në familje, duke marrë ndonjë raport edhe për muajin kundër kancerit të gjirit. Mund të thërrasim ndoshta edhe organizata të cilat janë duke u marrë më shumë me këto çështje.

Ajo përmendi që janë takuar me Hendikos-in, disa herë, që i ka ftuar ministra. Madje përmendi që edhe gjyqtarët të cilët nuk e kanë obligim të jenë prezentë, i kemi ftuar, si KGJK-në dhe KPK-në, lidhur me çështjet e luftimit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Ajo e përmend gjithashtu muajin e vetëdijesimit për kancerin e gjirit dhe informacionet shqetësuese për rritjen e numrit të pacientëve të kancerit të gjirit, që i takojnë grup moshës 30-40- vjeçare, duke ftuar anëtarët të propozojnë ide të reja.

**Kryetarja** konstatoi se në emër të komisionit, të bëhet plotësim-ndryshimi i draft-planit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor të vitit 2024, me propozimet të cilat dhanë anëtarët e komisionit.

## 5. Të ndryshme

**Arjeta Fejza**, sugjeroi të diskutojnë për vizitat në muajin e ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit.

**Ariana Musliu-Shoshi**, propozoi që të vizitojnë Repartin e Onkologjisë së Fëmijëve dhe radiologjinë, me planifikim për javën e dytë të tetorit.

**Kryetarja**, propozoi që komisioni të nxjerr një vendim, lidhur me çështjen e pagesës së dhuratave për fëmijët gjatë vizitës që do t'i bëhet Repartit të Onkologjisë, në mënyrë që më tutje mbi bazën e këtij vendimi, t'i drejtohem Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, për lejimin e mjeteve financiare.

Anëtarët e komisionit mbështetën në tërësi propozimin e kryetares.

**Arjeta Fejza**, propozoi të mbahet një mbledhje në javën e ardhshme, për dakordim për datat, duke thënë se vizita mund të bëhet potencialisht në datat 8-9 tetor, ku do të ketë kohë që edhe kërkesa e tyre për buxhet të trajtohet nga Kryesia.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Duda BALJE,  
Kryetare e Komisionit